



Konferenca V-të ndërkombëtare, Prishtinë, **Kolegji “Tempulli”**, 24.01.2018  
**Auditimi i Sigurisë Rrugore dhe Zvogëlimi i Aksidenteve në Trafik**

**Prezantimi:**

**Hulumtimet në trafik dhe roli i institucioneve profesionale, akademike dhe shkencore për një sjellje të kulturuar në rrugë**

Ahmet SHALA & Gëzim HOXHA

## **Siguria në trafik**

- Ndër problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës.
- Sfid për shoqërinë përmirësimi i sigurisë rrugore.
- Problem jo vetëm i vendit tonë, por problem global.

## **Trajtimi**

- Mobilizim institucional, investime në infrastrukturë, mirëmbajtje dhe nxitje të të gjithë pjesëmarrësve në trafik për:
  - sjellje më të mirë,
  - respektim të rregullave të qarkullimit, etj.

**Ndihmon** zbatimi i praktikave më të mira nga vendet e zhvilluara ashtu që të përmirësohet siguria në trafik në përgjithësi dhe zvogëlimi i numrit e aksidenteve, sidomos atyre me fatalitet në veçanti.

## Statistikat

**Numër i madh i të vdekurve** dhe i personave të lënduar rëndë në aksidente të trafikut rrugor,

**Kostoja e lartë e trajtimit** të lëndimeve dhe dëmeve materiale për buxhetin familjar dhe buxhetin e shtetit janë sfida të vazhdueshme të sigurisë së trafikut rrugor.

**Aksidentet** e tilla me përmasa shqetësuese, përveç humbjes së jetëve dhe dëmeve materiale, rrisin edhe **pasigurinë e pjesëmarrësve** në komunikacionin rrugor.

Sipas të dhënave nga rastet e aksidenteve në Kosovë, **shkaktarët** e aksidenteve rezultojnë të jenë të ndryshëm por përqindjen më të madhe e përbën **faktori njeri (veprimet dhe sjelljet e pjesëmarrësve në trafik)**,

## Hulumtimet

**Hulumtimet** lidhur me aksidentet rrugore si dhe vlerësimet e ekspertëve të FIM-së që janë marrë me superekspertiza të aksidenteve në Kosovë tregojnë se kontribues të numrit të lartë të aksidenteve në trafikun rrugor, janë:

- **shpejtësia** e lëvizjes,
- **mos respektimi i rregullave** të qarkullimit në përgjithësi,
- **mungesa e edukimit adekuat**, respektivisht e **përgatitjes adekuate të pjesëmarrësve në trafikun rrugor**, qofshin ata ngasës të automjeteve, drejtues biçiklete, këmbësorë, etj.
- **kohët e fundit edhe përdorimin e celularit** gjatë vozitjes apo gjatë kalimit të rrugës si këmbësorë.

Sipas një hulumtimi të bërë nga “VCÖ-Geschäftsführung Wien” është vërtetuar se:

- 20% të ngasësve shkruajnë “SMS” dhe 45% lexojnë “SMS” dhe e-mail gjatë ngasjes së makinës.
- 54% e tyre programojnë navigatorin gjatë ngasjes-voztjes, gjë që rritë mundësinë e aksidenteve në komunikacion.

Përdorimi i **celularit sidomos smartphone**, gjatë ngasjes së makinës është një fenomen që vërehet shumë edhe tek ngasësit në Kosovë. Kjo rritë për katër herë mundësitë për aksidente.

Në disa hulumtime tjera argumentohet se **përdorimi i internetit edhe shkrimi i “SMS”-ve** gjatë voztjes, e rritë mundësinë e aksidentit për **163** herë<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Dr. Willi Nowak Ablenkung im Straßenverkehr durch Nutzung von Mobiltelefon und Navigationsgeräten Wien, Februar 2014.

**Bazuar në hulumtime<sup>2</sup>**, për sjelljen e këmbësorëve gjatë kalimit të rrugës:

- Këmbësorët kanë prirje që të sigurohen për kalim të rrugës vetëm pak sekonda përpara se të fillojnë kalimin e rrugës.
- Ndërsa, pas hyrjes në rrugë, pothuajse asnjë veprim kontrolli të sigurisë nuk e bëjnë.

**Sipas një hulumtimi** (*survejimit të disa rrugëve dhe lokacioneve*) të realizuar në qytetin e Prishtinës, statistikave tregojnë se vetëm brenda një ore të monitorimit, në disa akse rrugore, janë bërë rreth 1300 shkelje nga këmbësorët. Këmbësorët kanë kaluar rrugën në vende të cilat nuk janë vendkalime për këmbësorë, për kundër asaj se vendkalimi nuk ka qenë më larg se 50 metra. Sjelljet e tilla paraqesin rrezik për këmbësorët dhe ulje të nivelit të sigurisë në trafik.

---

<sup>2</sup> Viewing behaviour as an accident cause – typical potential risks for pedestrians, EVU 2015

## Edukimi

Po thuaj të gjitha aspektet e sigurisë së trafikut janë të lidhura me sjelljet njerëzore

Sjellja njerëzore formohet gjatë gjithë jetës, në mënyra të ndryshme.

Një qasje primare në formimin e duhur të sjelljes mund filloj nga **njohuritë për rreziqet për t'u përfshirë në një aksident trafiku** dhe mundësitë për të shmangur atë.

Kjo arrihet përmes **institucioneve adekuate për edukimin** e grup moshave specifike.

Në këtë aspekt, në kuadër të institucionit tonë, shohim një rritje të aktiviteteve me studentë në të ardhmen dhe orientim të hulumtimeve shkencore në analizën e sjelljeve të pjesëmarrësve në trafik dhe karakteristikave të ngasësve në Kosovë, në mënyrë që të kontribuojmë më shumë në sensibilizimin e pjesëmarrësve në trafik, për një sjellje më të mirë dhe marrje të masave adekuate për evitimin e rreziqeve dhe aksidenteve të trafikut.


Edukimi për sigurinë rrugore është shumë thelbësor në botën e sotme, pasi trafiku rrugor po bëhet gjithnjë e më i ngarkuar.

Shumica e institucioneve arsimore në vendet e zhvilluara në Botë, organizojnë programe edukimi dhe aktivitete që ndihmojnë në rritjen e nivelit të sigurisë rrugore dhe përmirësimin e sjelljeve të pjesëmarrësve të trafikut.

**Kjo është më pak e shprehur në Kosovë dhe ende nuk ka një program zbatues të mirëfilltë i cili aplikohet në institucione edukative për të rritur ndërgjegjësimin për sigurinë në trafik. Prandaj, roli i institucioneve në këtë aspekt është mjaft i rëndësishëm dhe i domosdoshëm.**

- Ne kuadër të FIM-së, është duke u punuar me student dhe do të vazhdohet që të realizohen projekte dhe hulumtime të rasteve reale të aksidenteve në vendet në të cilat jetojnë apo vijnë këta studentë.





- **Qëllimi i hulumtimeve** është që përmes informatave të mbledhura nga analiza e aksidenteve nga zonat e ndryshme në Kosovë, komunikimi me policinë dhe analiza e dëshmive, të arrihet një lidhje gjeografike ndërmjet rreziqeve dhe shkaktarëve më të shpeshtë nga zonat përkatëse. Gjithashtu nga këto hulumtime tentohet të arrihen rezultate mbi mënyrën e sjelljes dhe reagimit të ngasëseve në situata të caktuara të paraqitjes së rreziqeve reale. Kjo do të ndihmoj pastaj në identifikimin e karakteristikave të ngasëseve (tipareve, personalitetit të tyre) apo pjesëmarrësve në trafik në Kosovë dhe marrjen e masave të duhura për të evituar shkaktimin e aksidenteve dhe përmirësimin sjelljeve të tyre.
- **Identifikimi i rreziqeve** nga analiza e aksidenteve dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me pjesëmarrësit në trafik do të ndihmoj sensibilizimin e tyre për të përmirësuar sjelljet dhe evituar rreziqet në trafik. Gjithashtu efektet në nivel më të gjerë mund të arrihen edhe nga informimi apo bartja e diskutimeve të studentëve me prindër dhe me shoqërinë.

- **Të kuptuarit dhe marrja e informatave** nga aksidentet nga ana studentëve dhe bartja e informatave nga ana e tyre, mund të jetë si qasje e re edukative e cila mund të ndihmoj në identifikimin e rreziqeve reale dhe marrjen e masave nga ana e të rinjve për të rritur sigurinë në trafik dhe përmirësuar sjelljen në shoqëri në tërësi.

Pra, **cak i këtyre hulumtimeve** është që nga “përvoja konkrete” (nga analiza dhe mbledhja e informatave nga aksidentet) të arrihen objektivat:

1. Ngritja e **diskutimeve** për sigurinë në trafik,
2. Rritja e **ndërgjegjësimit** për situatat kritike të trafikut dhe aksidentet,
3. Përmirësimi i **sjelljeve** të pjesëmarrësve në trafik,
4. Nxitja e diskutimeve në **familje dhe shoqëri** për sigurinë e komunikacionit,
5. Ndikimi pozitiv në **pjesëmarrësit e tjerë** të trafikut (p.sh. prindërit gjatë vozitjes),
6. Realizimi i kontakteve personale me ekspertë nga policia e trafikut dhe marrja e informatave të drejtpërdrejta nga aksidentet konkrete.

Ne kuadër të aktiviteteve dhe projekteve në të ardhmen, nuk përjashtohet edhe realizimi i projekteve në kuadër të FIM-së që kanë të bëjnë me fushata sensibilizuese për pjesëmarrësit e trafikut të **grup-moshave** të ndryshme. Me anë të këtyre fushatave tentohet të arrihet përcjellja e informatave lidhur me sigurinë rrugore dhe krijimin e vetëdijes të pjesëmarrësit e trafikut për problemet dhe mënyrën e duhur të sjelljes në situata të caktuara të paraqitjes së rrezikut.

Arritja e objektivave të BE-së dhe realizimi i vizionit “**Zero Aksidente**” nuk mund të paramendohet pa mbështetje thelbësore nga **Shkenca / Edukimi**, pa përjashtuar edhe ndikimin mjaft të madh që ka vullneti politik (institucionet qendrore apo lokale), koordinimi ndërmjet tyre, **mediat dhe ekspertët** që e kanë sjellë këtë çështje në qendër të vëmendjes.

Faleminderit

për

Vëmendje